

MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA E FINANCËS

RAPORTET E MONITORIMIT

12 - MUJORI -VITI 2016

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION
MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË DYMBËDHJETË MUJORIT
TË VITIT 2016

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 147 dt 17.12.2015, “Për Buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016” paragrafi IV “Monitorimi” Ministria e Kulturës, për 12-mujorin e vitit 2016, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për **12 - mujorin e vitit 2016**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 12– mujori 2016		Realizimi 12– mujori 2016		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	129,786	7.5%	124,095	7.3%	95.6 %
2.	Trashegimia Kulturore	570,612	32.9%	550,025	32.4%	96.4%
3.	Arti dhe Kultura	1,034,292	59.6%	1,025,067	60.3%	99.1%
	Totali	1,734,689	100%	1,699,187	100%	98%
	Financimi i huaj per investime	68,000	3.8%	59,699	3.4%	87.7%
	Totali me Financimet e huaja	1,802,689	100%	1,758,886	100%	97,6%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti është realizuar në masën 98%, ku rreth 60 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 99 %, ndjekur nga programi "Trashegimia Kulturore dhe Muzete" shpenzimet e të cilit zënë rreth 33 % dhe janë realizuar në masën 96 % dhe programi "Planifikim Menaxhimi Administrim" shpenzimet e të cilit zënë rreth 8% të totali dhe janë realizuar në masën 96%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2016		Realizimi 12-mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12		600-601	Paga, Sig.Shoq	850,138	49.0%	845,652	49.8%	99.5%
12		602-606	Shpen.Korrente	453,398	26.1%	443,743	26.1%	97.9%
12		231	Kapitale	431,153	24.9%	409,793	24.1%	95.0%
			TOTALI	1,734,689	100%	1,699,187	100%	98%
12		231	Jashtë buxhetore	68,000	3.8%	59,699	3.4%	87.8%
			TOTALI	1,802,689	100%	1,758,886	100%	97.6%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se shpenzimet për 12-mujorin e vitit 2016 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 100%, shpenzimet korentë 98%, dhe shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 95%.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 2% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve kapitale.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në total në masën 2.4% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i financimit të huaj.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatohet planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12– mujori 2016		Realizimi 12– mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	80,666	62.2%	79,249	63.9%	98.2%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	39,120	30.1%	39,037	31.5%	99.8%
12	01110	231	Kapitale	10,000	7.7%	5,809	4.7%	58.1%
			TOTALI	129,786	100%	124,095	100%	95.6%

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 96%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 62% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet korentë zënë rreth 30% të totalit dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 8% të totalit dhe janë realizuar në masën 58%.

Mosrealizimi i fondeve në masën 4.4% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

Në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 12-mujori 2016	Buxhet/Fakt 12-mujori i 2016
G-00323	Pajisje dhe punime ne ambjentet e MK	10,000	10,000	10,000	5,809
H-00323	Mbeshtetja ligjore e te gjitha aktivitetet te MK ne perputhje me programin e qeverise	12,982	12,982	11,993	11,836
I-00323	Menaxhim me efektivitet i burimeve njerezore dhe financiare per realizimin e objektivave	58,898	53,898	56,436	55,756
J-00323	Permbushje e detyrimeve financiare-ligjore	17,535	17,535	15,824	15,614
K-00323	Kontrolli i zbatimit me perpikmeri te legjislacionit te fushes	14,566	14,566	14,536	14,359
L-00323	Intensifikimi i bashkepunimit rajonal dhe nderkombetar	22,985	22,985	20,997	20,721
Totali		136,966	131,966	129,786	124,095

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithsëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për dymbëdhjetë mujorin janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore për 80 punonjësit e MK-së.

Për sa i përket produktit “Paisje elektronike dhe elektrike” gjatë kësaj periudhe ka patur blerje të pajisjeve kompjuterike elektrike gjithashtu dhe blerje pajisje zyresh si më poshtë:

- Blerjen e tre TV për Ministrinë e Kulturës
- Sistemi i kamerave të sigurisë në ambientet e Ministrisë së Kulturës
- Mobilimi i mensës në MK-në
- Blerje makinë korrëse bari elektrike për MK-në
- Salla e MK-së arredim me elementë të absorbimit dhe reflektimit akustik

Gjatë kësaj periudhe ka patur realizim të produktit “Akte ligjore dhe nënligjore”, projekt aktet si më poshtë:

- Projektligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë
- Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Rehovë, Ersekë, dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës përreth.
- Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga drejtoria për të drejtën e autorit.
- Për procedurat e regjistrimit, organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave autorit.
- Projektligj për pensionet e disa profesioneve të vështira të artistëve.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjes”, përveç të tjerave të përmendura në raportet e mëparshme, për këtë periudhë ka marreveshje/programe bashkëpunimi të miratuara;

- Program bashkëpunimi me Rusinë për vitet 2017-2019, e nënshkruar më nëntor 2016.
- Protokoll i takimit të Komisionit të përbashkët në kulturë, arsim dhe shkencë 2016-2020 me Austrinë është nënshkruar më nëntor 2016.
- Program bashkëpunimi me Poloninë për periudhën 2016-2019 e cila është nënshkruar në dhjetor të vitit 2016.

Në realizimin e Produktit “Auditime”, janë realizuar të gjitha auditimet që kanë qënë të planifikuara gjatë gjithë periudhës.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12– mujori 2016		Realizimi 12– mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08220	600-601	Paga, Sig.Shoq	261,499	45.8%	259,665	47.2%	99.3%
12	08220	602-606	Shpen.Korrente	155,533	27.3%	150,325	27.3%	96.7%
12	08220	231	Kapitale	153,580	26.9%	140,036	25.5%	91.2%
			TOTALI	570,612	100%	550,025	100%	96.4%
12	08220	231	Jashtë buxhetore	68,000	3.8%	59,699	3.4%	87.8%
			TOTALI	638,612	100%	609,724	100%	95.5%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 46 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99%, shpenzimet korrente zënë rreth 27% të totalit dhe janë realizuar në masën 97 % dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 27% dhe janë realizuar në masën 91%.

Mosrealizimi në masën 3.6% e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Mosrealizimi në total në masën 4.5 % e totalit konstatohet kryesisht në mosrealizimim e financimit të huaj.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë					08220
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 12-mujori 2016	Buxhet/Fakt 12-mujori 2016	
N-00324	Elemente te trashëgimise materiale e jomateriale te inventarizuara ne menyre dixhitale	20,408	20,408	20,408	20,408	
P-00324	Akte nenligjore te Ligjit te ri per Trashëgimine Kulturore te hartuara dhe miratuara	6,854	6,854	2,171	2,171	
S-00324	Monumente te restauruara dhe mirembajtura ne gjithë vendin	180,579	224,379	224,379	213,698	
T-00324	Muze dhe parqe arkeologjike me infrastrukturë te permirsuar per te ofruar sherbim cilesor ndaj vizitoreve	161,847	161,847	194,422	191,730	
U-00324	Aktivite te trashëgimise materiale, jomateriale dhe te diversitetit kulturor te organizuara ne rang vendi	34,871	34,871	43,653	41,683	
V-00324	4 Monumente kulture te restauruara (aparati MK)	89,200	122,233	118,000	112,521	
	Krijimi i Qendrave të informimit public per regjistrimin on-line te Pasurive Kulturore		23,167	35,579	27,513	
	Totali	493,759	593,759	638,612	609,724	

➤ **Muze dhe Parqe Arkeologjike me infrastrukturë të përmirsuar për të ofruar shërbim cilësor ndaj vizitorëve.**

Aktiviteti kryesor i Muzeve Kombëtarë është promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimise dhe aktiviteteve në funksion të saj. Një komponent i rëndësishëm është dhe pasurimi me fonde dhe përmirësimi i prezantimit përmes ekspozitorëve dhe përshkrimeve të objekteve në nivele bashkëkohore.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”.

Me VKM nr. 339 datë 04.05.2016 “Për krijimin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi” dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të godinës e të inventarizimit të mjeteve kryesore të Fototekës Kombëtare “Marubi” nga Ministria e Kulturës te ky Muze” është realizuar njohja zyrtare e Muzeut të ri Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, në kuadër të projektit “Muzealizimi dhe Restaurimi i Fototekës Kombëtare “Marubi”, si pjesë e projektit ndërrajonal “Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore të Rajonit të Adriatikut” i financiar nga fondet IPA-Adriatik të BE.

Në datën 9 Maj 2016 u realizua inagurimi i këtij institucioni të ri me një pjesëmarrje të gjerë të publikut, autoritete shtetërore dhe diplomatë të akredituar në Shqipëri. Njëkohësisht është miratuar edhe struktura e institucionit e përbërë me një staf prej 10 vetash.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, ka realizuar disa aktivitete në kuadër të promovimit të vlerave unike që prezanton ky institucion, ndër të cilat përmendim:

Ekspozita Marubi “499960”, 18-25 prill 2016, organizuar nga Ambasada Shqiptare në Berlin, Gjermani, Ministria e Kulturës dhe Fototeka Kombëtare “Marubi”, e konceptuar në 40 fotografi të vlefshme nga pikëpamja historike, sociale, kulturore dhe antropologjike.

Një ekspozitë e tillë u organizua për herë të parë në Gjermani, dhe shërbeu për të treguar një faqe europiane të Shqipërisë, e cila prej shekujsh ka qenë e lidhur nga ana kulturore dhe intelektuale me Europën. Ky aktivitet përkoi dhe me kohën kur për Fototekën Kombëtare Marubi po përgatiteshin procedurat për marrjen e statusit Muze Kombëtar.

- Ekspozita “Dinastia Marubi, 100 vite të studios fotografike shqiptare”, 16 Shtator-27 Nëntor 2016, organizuar nga Muzeu i Fotografisë së Amsterdemit, Hollandë-FOAM. Ekspozita është konceptuar të përbëhet nga 36 fotografi në xham negativë, 178 fotografi të printuara dhe 88 fotografi me video-projektim të cilat paraqesin një interes të vecantë në këndvështrimin historik, social- kulturor , antropologjik si dhe atë artistik.

Projekti i ri për ngritjen e Muzeut të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”.

Ka përfunduar hartimi i projektit të muzealizimit përmes miratimit të tij në Komisionit Shtetëror të Muzeve (detyrim sipas ligjit nr. 9386 datë 04.05.2005 “për muzete” dhe njëkohësisht ka filluar zbatimin e tij. Njëkohësisht vazhdon puna lobuese për ngritje të fondeve nga donatorë për t’i bashkuar me fondin aktual nga buxheti i shtetit për këtë muze. Në tremujorin e katërt kanë vazhduar takimet me ekspertët e huaj në kuadër të hartimit të projektit përfundimtar të muzealizimit, gjithashtu është zhvilluar dhe një takim me grupet e interesit për muzeun. Ky muze është një nga prioritetet kryesore të MK. Hapja e tij përmes procedurës së miratimit në Këshillin e Ministrave do të realizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2017, kohë që do të shonojë dhe hapjen për publikun.

Muzeu Historik Kombëtar.

Gjatë vitit 2016 Muzeu Historik Kombëtar, si një ndër institucionet më të rëndësishme në vend ka realizuar aktivitete në kuadër të promovimit të vlerave që ky institucion përfaqëson për historinë dhe trashëgiminë në vend, por dhe në zbatim të prioritetit kryesor të MK “Edukimi përmes trashëgimisë kulturore”

Muzeu Historik Kombëtar realizon një sërë aktivitete si konferenca, ekspozita, takime përkujtimore, ndër aktivitetet e rëndësishme të zhvilluar ka qenë konferenca dhe ekspozita **“Qytete të lashta dhe peisazhe të shqipërisë, një shekull hulumtimesh arkeologjike italo-shqiptare”** në datat 12 prill -20 maj 2016 një bashkëpunim i Institutit Italian të Kulturës, Institutit Arkeologjik dhe Muzeut Historik Kombëtar. Ekspozita ikonografike dhe ornamentike: **“Thesare të shpëtuara”**, në kuadër të 29 shtatorit, “Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore”. Ekspozita u zhvillua nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar dhe Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Qëllimi i saj ishte ndërgjegjësimi i opinionit publik mbi rëndësinë e ruajtjes së thesareve të trashëgimisë kulturore.

Janë realizuar dhe aktivitete me karakter edukues për brezin e ri si “Arkeologu vogël” ; “Miku muzeut” “ Muzeu im”, Vizatohet historinë” “Një ditë me kuratorin”, mbi njohjen, rëndësinë dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

“Një ditë me kuratorin” është inisiativa më e re e Muzeut Historik Kombëtar, që synon të përforcojë bashkëpunimin e muzeut me publikun e gjerë, të rrisë ndjeshmërinë e brezave të rinj ndaj objekteve muzeale, të evidentojë rolin e kuratorit të një muzeu, si dhe të inkurajojë dialogun me qytetarët mbi historinë e kulturën. Gjithashtu janë zhvilluar një sërë ekspozitash me tematikë të ndryshme si dhe një sërë aktiviteteve nga muzeu në përkujtim të figurave dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore.

Në kuadër të 35 vjetorit të Muzeut Historik Kombëtar në 28 Tetor 2016, është realizuar ekspozita në Hollin kryesor, njëkohësisht me mbështetje të Ministrisë së Kulturës përmes një fondi prej 700.000 mijë lekësh është realizuar një rikonceptim i etiketave të objekteve më të rëndësishme të ekspozuara në MHK si dhe organizimi i një konference dedikuar punës së Muzeut në këto vite, sfidat dhe detyrimet për të sjellë procesin e prezantimit të objekteve dhe historisë në nivele bashkëkohore.

Njëkohësisht MHK është pjesë e procesit të projektit të rehabilitimit të Sheshit kryesor të Tiranës ku përfitimi në këtë process është vlerësimi i të gjithë ambjentit rrethues të muzeut dhe vlerësimi të aksesit të publikut në këtë institucion.

Godina e re e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë.

Ka përfunduar ndërtimi dhe Muzealizimi i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë, apo «Qendra për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore», në Godinën e re, bashkëpunim i Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Kulturës. Është finalizuar hapja për publikun në datën 3 Tetor 2016 ku është realizuar zhvendosja e fondit me të gjithë objektet e ekspozuara.

Muzeu i Arsimit, Korçë, në ambientet e tij janë zhvilluar aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore të krahinës së Korçës dhe të Shqipërisë, ku janë ekspozuar fotografi, dokumenta, objekte të ndryshme, dhe janë shfaqur dokumentarë.

Një ndër aktivitete kryesore u zhvillua në 29 Shtator, Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore në ambientet e Muzeu të Arsimit, ku në bashkëpunim me qytetarë korçarë dhe dashamirës të artit u organizua një ekspozitë rreth historise dhe personazheve të muzikës korçare. Aty u ekspozuan fotografi të këngëtarëve të vjetër, grupeve, sazeshinjeve e mjeshtërve popullorë, vegla muzikore të vjetra, me të cilat janë interpretuar këngë popullorë dhe serenata, disqe gramafoni, ku janë regjistruar këngë të zonës së Korçës.

Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat,

Janë realizuar njësrë aktivitete me karakter promovues, edukues si dhe ngritje të kapaciteteve përmes trajnimeve si brenda dhe jashtë vendit. Një ndër aktivitet që shoqëron punën në muze ka qenë dhe pasurimi i fondit me objekte të reja si dhe përmirësimi i prezantimit tek publiku.

Në kuadër të “18 Maj Ditës Ndërkombëtare të Muzeve” Qendra Kombëtare e Muzeve Berat, organizoi në Muzeun Ikonografik Onufri, ekspozitën: “Thesare të Fjetura”. U çel salla e katit të dytë (salla nr. 4) në Muzeun Ikonografik Onufri, që prej afro 13 vitesh ka qenë e mbyllur dhe jashtë funksionit të saj ekspozues. Janë gjithsej 17 vepra të Artit Ikonografik të organizuara në ekspozitën "Thesare të fjetura" të cilat prezantohen për herë të parë për publikun, një seri ikonash nga kryemjeshtërat: Onufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, Johan Cetiri etj.

Qendra Kombëtare e Muzeve, Berat e prezanton këtë koleksion për publikut si një produkt të ri të pa ekspozuara më parë, në sezonin turistik 2016 - 2017. Projekt u organizua në kuadër të 30-vjetorit të çeljes së Muzeut Ikonografik Onufri dhe qëllimi kryesor i hapjes së kësaj ekspozite, ishte kthimi i sallës së katit të dytë të MIO, në indetitetin e vet, duke e bërë një ndër pjesët më të rëndësishme të ekspozitave permanente.

Gjithashtu janë zhvilluar aktivitete në kuadër të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore si: Ekspozita “**Tradita popullore me riprodhime nga kostumografia e trevave shqiptare**”, ekspozitën me produkte stolish artizanale dhe zbukurimi, me qëllim evidentimin e vlerave të produkteve artizanale. “**Muzeu Shëtitës**” Ekspozitë me foto në forex me kavaleta nga objekte të fondit të Muzeut Ikonografik Onufri etj.

Në “Ditën Kombëtare e Trashëgimisë” & “Ditët Evropiane të Trashëgimisë Kulturore”, u zhvilluan

-Ekspozita “**Muzeu Shëtitës**” , me imazhe nga fondi i Muzeut Etnografik dhe Muzeut Ikonografik Onufri, organizuar nga QKM Berat në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Lushnje. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që koleksioni të bëhet më i njohur dhe më atraktiv për publikun, dhe krijimi i një rrjeti aktiv bashkëpunimi ndër institucional me muzet e tjerë kombëtar dhe lokal, duke shkëmbyer eksperiencë mes njëri - tjetrit, në raport me trashëgiminë kulturore & muzeale.

-Aktiviteti **“Art i kulinarisë në Berat”**, me qëllim promovimin e vlerave të veçanta të kulinarisë beratase si pjesë e Trashëgimisë Kulturore shqiptare, si simbol i mikëpritjes, kënaqësisë dhe begatisë.

Muzetë Kombëtarë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik, Krujë.

Kryesisht puna në të dy muzetë është fokusuar të ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dy muzeve si dhe në realizimin e disa aktiviteteve me karakter promovues dhe edukues për vizitorin dhe nxënësit e shkollave.

Përmes disa aktiviteteve përmenden festimi Ditës Ndërkombëtare të Guidave Turistike - 21 Shkurt, organizuar nga Shoqata e Guidave Turistike NATGA, në bashkëpunim të ngushtë me Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti” dhe Muzeun Etnografik të qytetit të Krujës si dhe me Shkollën 9 Vjeçare nr.1, Krujë dhe TID Krujë. Dita ndërkombëtare e Muzeve përmes realizimit të disa aktiviteteve në të dy muzetë në bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore dhe pushtetin vendor. Në ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, Shoqata TID Kruja, në bashkëpunim me Bashkinë Krujë, Agjencinë për Zhvillim Rajonal, AADF dhe Muzeu Etnografik organizuan seminarin me temë “Forcimi i mëtejshëm i trashëgimisë kulturore dhe artizanatit, një mundësi reale në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të rajonit tonë” me pjesëmarrje shumë të gjerë të shumë specialisteve të trashëgimisë.

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë.

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë gjatë vitit 2016 ka kryer një sërë aktiviteteve në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historike-kulturore, ekspozita të aristëve të rinj, promovime librash, me fokus kryesor promovimin e trashëgimisë sonë kulturore.

Në 18 Prill, Ditën e Monumeneteve në bashkëpunim me DRKK Vlorë ka zhvilluar aktivitete për sensibilizimin e publikut mbi njohjen, rëndësinë e mbrojtjes dhe promovimin e vlerave të Monumeneteve Kulturore. Në 18 Maj Ditën Ndërkombëtare të muzeve organizoi vizita të lira në muze si dhe bashkëbisedime me nxënësit e shkollave lidhur me rëndësinë e kësaj dite, atë të vlerave muzeale. Me rastin e 29 Shtatorit Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, Muzeu organizoi bashkëbisedime me nxënësit e shkollave të mesme mbi rolin, rëndësinë dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Organizimi i një Koncerti polifonik, për të përcjellë mesazhin e kësaj dite si dhe ndërthurjen e trashëgimisë kulturore material me atë jomateriale. Organizimi i një ekspozite me artistë të qytetit, me fokus trashëgiminë kulturore, duke sensibilizuar komunitetin për rëndësinë e ruajtjes së këtyre vlerave.

Gjatë 12 -muorit janar-dhjetor të vitit 2016 në parqet arkeologjike janë kryer në vijimësi:

- Restaurim/konservim dhe mirëmbajtjen e strukturave arkitektonike dhe arkeologjike
- Mirëmbajtjen e territorit, pastrim nga vegetacioni i lartë dhe i ulët
- Organizim i aktiviteteve kulturore me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditave lokale, ndërgjegjëzimin dhe përfshirjen e komunitetit dhe nxënësve të shkollave të sistemit parauniversitar.

Gjatë 12-muorit të vitit 2016 në parqet arkeologjike janë zbatuar projekte restaurimi, konservimi dhe mirëmbajtje financiarisht të mbështetura ngë Buxheti i Shtetit dhe projekte financiarisht të mbështetura nga fondet IPA (BE).

Në PK Butrint gjatë 12-muorit të vitit 2016 (me të ardhurat e ZAK Butrint) janë realizuar:

- Mirëmbajtje: Menaxhim vegetacioni në sitin arkeologjik të Diaporitit, Fushë Vrinës dhe Kulla e Vrojtimit
- Mirëmbajtje: Ruajtja me roje private dhe sistem alarmi në Parkun Kombëtar Butrint dhe në muzeun arkeologjik Butrint,
- Investim: Projekti i ndërtimit të tualeteve publike në Butrint

- Botimi i librit “Historia e Arkitekturës (Butrintit)” dhe broshurave “Trashëgimia e ndërtimeve me teknikën e gurit të thatë në rajonin e Adriatikut” dhe “Valorizimi i siteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura nga UNESCO nëpërmjet projekteve pilot”, vlera e financimit nga fonde të Parkut Kombëtar Butrint dhe Fonde të BE nga programi IPA Adriatik CBC.
- Plani i rilevimit dhe përgatitja e hartës topografike për nënzonat A3 të Parkut Kombëtar të Butrintit,
- Hartimi projektit për punime konservuese dhe restauruese brenda zonës së qytetit antik të Butrintit,
- Konservim - restaurim i murit Butrint – Sarandë - Muri te Porta e Liqenit
- Hartimi i projektit për Reabilitimin e Parkut të Butrintit përmes ndërhyrjeve përmirësuese të pemëve, në fazë hartimi nga Agjencia kombëtare e zonave të mbrojtura.

Në Parqet Kombëtare Arkeologjike Apoloni dhe Bylis gjatë 12-mujorit 2016 janë kryer punime mirëmbajtje dhe pastrim vegjetacioni nga punonjësit e institucioneve.

Në ZAKPA Apoloni është kryer: Pastrim dhe prerje vegjetacioni në objektet bouleterioni, odeoni, biblioteka, stoa A dhe B si edhe të ish-muri i Amforave, tempulli jonik, prytanioni, faltore A dhe B, magazinat, muri Temenosit, muri rrethues në anën lindore, kulla e rrumbullakët, Terma, banesa D me mozaik, Vila me impluvium, Teatri, rruga H. përgjatë rrugës së asfaltuar brenda parkut si edhe në sheshin përgjatë rrugës drejt Qendres Monumentale.

Në ZAKPA Bylis është kryer pastrim në objektet: bazilikat, teatri, stera, stadiumi, arsenal, prytaneoni, të dyja stoat si ajo e madhe dhe ajo e teatrit, banesa A dhe B, banesa e Terencianit dhe muri i Viktorinit nga të dy anët dhe muri rrethues i periudhës helenistike.

Në parkun Kombëtar të Arkeologjisë Apolloni vazhdon Projekti: **“Reabilitimi i Manastirit të Shën Marisë për përdorim muzeal dhe peisazhit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë”**, Fier, financim BE dhe bashkëfinancim MK.

Projekti ka nisur të zbatohet në janar 2016. Janë kryer punime në:

- Restaurimi dhe konservimi Portikut të Statujave
- Restaurimi dhe konservimi i kishës dhe
- Zona e parkimit

Gjatë vitit 2016 në kuadër të zbatimit të këtij projekti MK ka likujduar 8,295,310 lekë TVSH (detyrim i përfituesit).

Pagesat e bëra nga Delegacioni i BE për 2016 janë si më poshtë:

Punimet: 402,070.93 EUR (vlera e kontratës 695,034.57 EUR)

Supervision: 34,630.00 EUR (vlera e kontratës 61,650.00 EUR)


Gjatë vitit 2017 do të vazhdojë pagesa e bashkëfinancimit dhe TVSH

Në Parqet Arkeologjike janë organizuar një sërë aktivitete në kuadër të ditëve ndërkombëtare të Muzeve, të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve dhe të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë, sezonit turistik veror që kanë kontribuar në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditave lokale dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve vendase.

Në zbatim të Udhëzimit nr 1808, dt. 7.04.2016 “Për mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore gjatë sezonit turistik veror 2016”, kanë raportuar rregullisht dhe zbatuar në vijimësi masat në kuadër të sezonit turistik veror 2016.

Vizitueshmëria në periudhën Janar – Dhjetor 2016

Trendi i vizitueshmërisë në qendrat e trashëgimisë shënon **rritje progresive** në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015. Muajt **maj** (për 6-mujorin e parë të vitit) dhe gusht (për 6-mujorin e dytë) kanë shënuar statistikën më të lartë të vizitueshmërisë, tendencë kjo e përsëritur edhe në vitet paraardhëse. **Theksojmë se numri i vizitorë me biletë dhe të ardhurat e gjeneruar prej tyre kanë njohur rritje progresive.**



- **4 Monimente kulturore të restauruara nga aparati MK,**
- **Monimente të restauruara dhe mirëmbajtura në gjithë vendin**

Në vitin 2016 planifikimi i fondeve për investime në restaurimin e Monumenteve të kulturës dhe Muzetë ishte në masën 121,200,000 lekë

Në përmbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës : “Të ruajë, mbrojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore gjatë vitit 2016 i kushton vëmendje të veçantë **Rehabilitimit të Monumenteve të Kulturës për t’i shndërruar ato në produkte turistike kulturore.**

Gjatë vitit 2016 është realizuar:

- Rikonstruksion i banesës ku u ngrit flamuri në Korçë,
- Përfundimi i Restaurimit, Kisha e Shën Thanasit, Karavasta Lushnje,
- Rikonstruksion - "Ndërhyrje rehabilituese në nënçatinë e objektit Ish-kinostudio Shqipëria e Re"
- TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë.
- Sistemi i disinfektimit, konservimit dhe ruajtjes sse ikonave ne muzeun Mesjetar Korçë

Një pjesë e fondeve me destinacion mbulim TVSH dhe bashkëfinancim për projektin e mësipërm u rialokuan për restaurimin e disa objekteve monument kulture të cilat ishin në gjendje kritike.

Ndërhyrjet restauruese dhe rikonstruksionet u realizuan në objektet :

Rikonstruksion i banesës ku u ngrit flamuri në Korçë. Shtëpia ku është ngritur Flamuri i Krahinës Autonome të Korçës ka qenë Monument Kulturore i kateg. I që në vitin 1977 dhe që prej këtij viti ka shërbyer si Muze Historik i Qytetit të Korçës. Pas rrënimit të saj në 16 Gusht 2012, Këshillit Kombëtar i Restaurimit me Vendimin nr.16 datë 30.05.2014 miratoi projektin e rindërtimit të saj sipas projektit original. Godina shënon një moment të rëndësishëm në përpjekjet e popullit shqiptar për të konsoliduar shtetin pas shpalljes së Pavarësisë më 28 Nëntor 1912. Ndërtimi i shtëpisë, pritet me mjaft interes nga vetë banorët e qytetit, pasi ajo ndërtesë ruan një nga ditët më të veçanta të historisë dhe krenarisë së banorëve të këtij qarku dhe të gjithë Shqipërisë. Në muajin Shtator kanë filluar punimet, përfundimi i objektit do të jetë në korrik 2017.

- **Restaurim Kisha e Shën Thanasit, Karavasta Lushnje,** përfundimi i plotë i punimeve dhe likuidimi i tyre. Objekti ju nënshtrua ndërhyrjeve restauruese të plota të çatisë, muraturës, dysHEMEVE dYerve dhe dritareve, restaurim i plotë i tavanit dekorativ dhe i pikturës murale, ndërtim i ikonostasit te ri (nga ikonostasi origjinal i objektit ruhen vetëm disa elementë druri të gdhendur).

- Mobilim i brendshëm i kishës, ndriçim i naosit dhe sistemim i territorit përreth objektit. Kisha e Shën Thanasit në Karavasta është shndërruar në një destinacion dinjitoz për turizmin kulturor. Likuidimi ka përfunduar.
- **Rikonstrukcion** - "Ndërhyrje rehabilituese në nënçatinë e objektit Ish-kinostudio Shqipëria e Re". Përfundoi rehabilitimi i nënçatisë në objektin Ish-kinostudio Shqipëria e Re, përshtatur për zyra për disa institucione në varësi të Ministrisë së Kulturës.

MIRMBAJTJA E MONUMENTEVE TË KULTURËS (Art. 602)

Gjatë vitit 2016 janë kryer punime mirëmbajtjeje, konsolidimi, pastrim vegjetacioni dhe restaurimi **në rreth 150 Monumente Kulture** nga DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë të cilët përgatitën objektet e trashëgimisë kulturore për sezonin turistik si dhe vazhdon mirëmbajtja rutinë e tyre dhe mbrojtja nga dëmtimet dhe degradimi nga agjentët atmosferikë.

- **DRKK Durrës** ka kryer punime mirëmbajtjeje, pastrim nga vegjetacioni, restaurime në rreth **25 objekte Monument Kulture**, kështu janë kryer pastrime dhe mirëmbajtje në Kishën e Gjon Pagëzorit në fshatin Derven në Krujë, në Mozaikun e Tiranës, në Amfiteatrin Durrës, në Kalanë e Elbasanit, Hamami Mesjetar në Durrës, Muret Rrethuese të qytetit të Durrësit, në Macellum Forum (Rotonda), Termat Romake, Pusi i Top Hanes, në Banesën Aleksander Moisiu , në Kepin e Rodonit, etj.
- **DRKK Berat**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit dhe në disa objekte edhe në bashkëpunim me pronarët ka kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtëse, konsolidime, pastrime nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë, **në 26 objekte monument kulture** kështu: Restaurim i çatave të disa banesave të lagjeve historike. Restaurimi i murit kufizues pranë kullës nr. 14 në Kala, Berat (tek Tabja). Ndërhyrje (e pjesshme) restauruese në çatinë e Kishës së Shën Triadhës në Kala, pastrim nga vegjetacioni dhe punime mirëmbajtjeje dhe pastrimi të ambjentit të jashtëm dhe të brendshëm në 3 lagjet e Qendrës Historike dhe të Kishave në lagjen Kala, etj.
- **DRKK Korçë**, ka kryer punime në **16 objekte**, si mirëmbajtjeje, restauruese në zonën e Pustecit dhe në Bazilikën e Linit. Punime restauruese në zonën e Voskopojës në kishën e Shën Mërisë dhe në kishën e Shën Dhimitrit. Punime restauruese të kishës dhe konservuese të pikturës murale në kishën e Shën Dhimitrit, Boboshticë. Konsolidime në kishën e Shën Thanasit, Voskopojë, si dhe vendosje sinjalistike në Kishën e Shën Marias, Voskopojë , Punime Restaurimi në Tumën e Kamenicës dhe ndërhyrje mirëmbajtjeje në banesën e Vëllazërisë Icka, Pogradec.
- **DRKK Gjirokastrë**, ka kryer punime mirëmbajtjeje në rreth **40 objekte** monument kulture, kështu u kryen restaurim porte i banesës "Stavri" dhe banesës "Kokobobo", restaurim i fasadas ballore të banesës "Beqiri" katg.I, Ndërhyrje restauruese dhe përforcuese në disa çati në Pazar si banesa "Shehu", banesa "Kodra" në banesën e "Zekatëve", të banesës "Xhezo" dhe "Reso" dhe tek dyqani "Demiri", dyqanit "Kuka", Muzeut Etnografik etj. Ndërhyrje restauruese përforcuese të banesës "Ciu" dhe "Shaplo", ndërhyrje restauruese në Kishën e Labovës së Kryqit, pastrim i bimësisë në banesën "Çabej" dhe në Kala. Përforcime në Parkun e Antigonesë, Restaurim i spërthit banesa "Papadhopulli" dhe banesa "Ndreu", F/V portë druri në kala, F/V portë dritaret dekorative në fasaden jugore të banesës "Skënduli", restaurim Porta " Gjebre" etj. Mirëmbajtjeje në kishën e Vllaho Goranxisë etj. Zëvendësim i dritareve në banesën në Buall, pastrim vegjetacioni dhe spërkatje me herbicid në Antigone, pastrim dhe sistemim në Adrianopol. Hapja e shtegut nga Nimfeu tek Kisha e Shën Mëhillit. Pastrime dhe mirëmbajtjeje në kalanë e Zharrës, Ura e Beqishtit, akuaduktit të Bençës, etj.
- **DRKK Vlorë**, u kryen punime mirëmbajtjeje dhe pastrim vegjetacioni në **32 objekte** monumente kulture dhe parqet Arkeologjike, si në Xhaminë Muradies ,P.A.Amantia, P.A.Orikum, P.A.Finiq, Qyteti Antik Olimpia, Ujesjellësi i Ferunit, Ujësjellsin e Vranishtit, Ura e Tragjasit, Kullat e Dervish Aliut në Dukat, Rrënojat e fshatit Tragjasi i Vjetër. Fragment i portës hyrëse së Kalasë së Onhezmit, Sarandë, Konservim-Restaurim i Urës së Slapit, Ura e Bratit, Xhaminë e Kalasë së Borshit , Muzeu Historik (Vlore), Kisha e Shën Janit, Delvinë, etj.

- **DRKK Shkodër**, u kryen punime mirëmbajtje dhe pastrimi periodik nga punëtorët e mirëmbajtjes në monumentin Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Drishtit dhe Kalaja e Lezhës. Pastrim nga vegjetacioni dhe vendosje e pllakës së gurit në monumentin Ish Arqipeshkvia Durrësit, Delbnisht. Pastrim nga vegjetacioni në monumentin Rrenojat e Kishës së Shigjit. Pastrim nga vegjetacioni dhe vendosje e pllakës së gurit në monumentin Ura e Mesit, konservimi dhe restaurimi në Kalanë e Shkodrës ku u krye restaurimi i Kullës Lindore në oborin e dytë.

➤ **Aktivitetet të trashëgimisë materiale, jomateriale dhe të diversitetit kulturor të organizuara në rang vendi.**

Në kuadër të objektivave për vitin 2016, Ministria e Kulturës nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithëshme të Planifikimit Strategjik të Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet e sistemit të trashëgimisë kulturore kanë organizuar një seri veprimtari lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur për qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës:

➤ **Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit 2016**

- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare në Elbasan, organizuar në qytetin e Elbasanit më 11-12 mars 2016.
- Shpallja e konkursit “*Legjendat Shqiptare në Novelat Grafike*”, edicioni III-të dhe organizimi i dy seminare përgatitore me ekspertët e fushës me pjesmarrësit në konkurs në muajin maj e qershor.
- Festivali “*Aulona Folk*”, zhvilluar në qytetin e Vlorës, më 12-14 maj 2016.
- Festivali i 13-të i instrumentistëve të vegjël popullorë, organizuar në muajin maj 2016 në qytetin e Fushë Arëzit.
- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore, zhvilluar më 20-21 maj në qytetin e Korçës.
- Festivali Folklorik “*Përmeti Multikulturor 2016*”, organizuar në qytetin e Përmetit më 22-24 qershor 2016.
- Hapja e ekspozitës fotografike dhe promovuese në Prizren: në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Kosovës u zhvillua një ekspozitë fotografike e përgatitur nga DRKK Vlorë dhe Shkodër, si dhe u përgatit pjesmarrja e grupit polifonik “*Jonianët*” për shfaqje, nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës.
- Projekti “*Logu i Bjeshkëve*” organizuar nga Gusht 2016 në qytetin e Malesisë së Madhe, Lepushë.
- Projekti “*Kronikë në Dropull*”, paraqitur nga CONNEXT SH.P.K, organizuar më 07-15 gusht 2016 në Dropull.
- Pjesmarrje në organizimin e aktivitetit folklorik, paradë e kostumeve popullore dhe koncert folklorik me rastin e 29 shtatorit “*Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore*”, zhvilluar në qytetin e Tiranës, në Sheshin “3 vëllezërit Frashëri” më 29 shtator 2016 nga QKVF.

- Projekti “*Oda Dibrane*”, paraqitur nga z. Veli Vraniçi, zhvilluar më datë 17-19 nëntor në qytetin e Dibrës së Madhe, Maqedoni dhe në qytetin e Peshkopisë.
- Projekti “*Bunker Plis*”, paraqitur nga z. Fation Murati zhvilluar më datë 27 nëntor në qytetin e Tiranës.
- Projekti “*Qilimat me motive autentike Shqiptare*”, paraqitur nga Shoqata e Stilistëve Shqiptarë. Promovuar në sallën “*T.T.Koço*” në Ministrinë e Kulturës më datë 22 nëntor 2016 me pjesëmarrjen e autores znj. Anila Zajmi.
- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë, zhvilluar më 24-25 nëntor në qytetin e Lezhës.
- Konkursi “*Novelat Grafike Shqiptare nr.3*”. Promovuar në ambjentet e Ministrisë së Kulturës më 25 nëntor 2016 ku u hap ekspozita me punët e pjesëmarrësve dhe u ndanë çmimet dhe botimi “*Legjendat Shqiptare në Novelat Grafike nr. 3*”.
- Hartimi dhe dorëzimi në UNESCO i projektit “Inventarizimi i trashëgimisë kulturore materiale me bazë komunitetin”
- Dokumentim-Regjistrimi i Dijenive të Mjeshtërisë së Punimit Tradicional të Instrumentit Muzikor “Cylja Dyjare” (Longare, Biculja) dhe të ekspozitës “Instrumente Muzikore Tradicionale” Në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, në Zhulat, Gjirokastrë.

Veprimtari Miku i Monumentit 2016 dhe veprimtari të tjera të DRKK

- **Vizita në Muzetë Etnografikë**
- Në kuadër të programeve të edukimit kulturor nxënësit e shkollave të përfshira tashmë në rrjetin “Miku i Monumenteve” kanë zhvilluar vizita në muzetë etnografikë. Aty kanë zhvilluar jo vetëm vizita njohëse me trashëgiminë kulturore jomateriale të zonës së tyre, por kanë zhvilluar edhe orë mësimi edukative. Berat, Kruja, Elbasani etj
- **Kostumet Popullore**
- Kostumet popullore të zonave të tyre kanë qenë në vëmendjen e mësuesve përkatës dhe nxënësve të rrjetit “Miku i Monumenteve”. Në formë konkursesh, ekspozitash fotografike dhe projektesh mësimore, nxënësit kanë studiuar, njohur dhe prezantuar veçoritë e kostumeve të zonave nga vijnë dhe ku jetojnë. Berat, Gjirokastrë, Shkodër etj
- **Aksion Pastrimi në Kala**
- Aksionet për pastrimin e kalave dhe monumenteve nga nxënësit e “ Mikut të Monumenteve” janë zhvilluar në të gjitha DRKK. Nxënësit kujdesen për ambientin rreth monumenteve dhe mësojnë njëkohësisht.
- **Leksione për Trashëgiminë Kulturore**
- Orë të hapura mbi edukimin kulturor në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave duke nxitur vetëdijen kulturore janë zhvilluar në Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë etj
- **18 Prilli “Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve**
- Në kuadër të 18 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve” në të gjitha DRKK janë zhvilluar aktivitete me nxënës të rrjetit “ Miqu të Monumenteve”. Në **Berat** është zhvilluar panair i tarshëgimisë, në **Gjirokastrë** u organizua ekspozita fotografike “Një foto sa mijëra fjalë”, në **Durrës** u organizua aktivitet me temë nga trashëgimia sportive, në **Vlorë** pati vizita në monumente dhe aktivitete të ndryshme, në **Korçë 18 Prill 2016** në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve, në ambjentet e Hanit të Elbasanit, Pazari Korçë, u zhvillua një aktivitet me nxënës të Gjimnazit "Themistokli Gërmenji", në **Shkodër** janë zhvilluar ekspozita, në Kukës konkursi “ Të njohim kështjellat e Kukësit”, Në Tropojë njohje e nxënësve me Kalanë Geghysen Tropojë etj
- **Panaire kulinarie**

- Në kuadër të njohjes së të rinjve me traditat më të mira të kulinarisë të trashëguara brez pas brezi, janë organizuar mini panaire kulinarie në shkolla dhe më tej. Nxënësit kanë hulumturi dhe studiuar, më pas përgatitur dhe paraqitur ushqime tradicionale të familjes së tyre, duke përfaqësuar vlerat më të mira të zonave nga vijën dhe jetojnë. Berat, Elbasan, Gjirokastrë etj
- **Aktivitetet në kuadër të 18 Majit- Ditës Ndërkombëtare të Muzeve**
- Edhe në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve janë zhvilluar aktivitete në DRKK të ndryshme. Kështu në Shkodër është organizuar vizitë në Muzeun më të ri Kombëtar, Fototekën Marubi.
- Gjithashtu, në kuadër të 18 Majit Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, nxënësit e klases së IX të shkolles Sotir Gura, Korçë vizituan Muzeun Kombëtar të Arsimit dhe Muzeun Arkeologjik. Ndërsa në Pogradec, nxënësit e shkolles "Muhamer Esat Minarolli" vizituan Fototekën "Misto Cici".
- Me mbarrimin e vitit shkollor, ndryshon edhe tipologjia e punës dhe e aktiviteteve. Specialistët e nismës së "Mikut të Monumentit" dhe Trashëgimisë Jomateriale, vazhdon nisma Edukimi nëpërmjet kulturës, me krijimin e disa aktiviteteve, dhe shkollave verore, me bashkpunime të ndryshme.
- **29 Shtatori Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore**, Në këtë ditë u organizuan shumë aktivitete nga të gjithë institucionet në kuadër të promovimit të Trashëgimisë sonë Kulturore. Aktivitetet synojnë promovimin e vlerave të Trashëgimisë, traditës dhe kulturës së ruajtur ndër breza dhe e risjellë në ditët e sotme si pjesë e Trashëgimisë Kombëtare dhe pjesë e Trashëgimisë madhe Evropiane.
- **Procesi i inventarizimit**, një aktivitet i rëndësishëm për DRKK është edhe angazhimi në evidentimin e dukurive të trashëgimisë kulturore jomateriale në kuadër të fillimit të procesit të inventarizimit të dukurive të trashëgimisë kulturore jomateriale për krijimin e një regjistri kombëtar. DRKK paraqitën elementët më të spikatur të dukurive të zonave përkatëse dhe po punojnë për pasurimin e dosjes për secilën dukuri.
- **Në kuadrin e Fushatës Kombëtare të Leximit, "Takohemi për një libër"**, Aktivitet të shumta u organizuan nga të gjitha DRKK dhe DAR në të gjitha rrethet, Leximi në këto aktivitete u drejtua më tepër se si të njohim monumentet e kulturës nëpërmjet librit si dhe biseda miqësore mes autorësh dhe miq të librit.
- **Festojmë Pavarësinë dhe Çlirimin e Atdheut**. Shkollat organizuan aktivitete të ndryshme kulturore për të festuar Festat e Çlirimit dhe Pavarësisë në objektet Monument Kulture në mbarë vendin.

➤ **Elemente të trashëgimisë materiale e jomateriale të inventarizuara në mënyrë dixhitale**

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore është institucion i specializuar nën varësinë e Ministrisë së Kulturës, krijuar me Vendim të KM Nr. 142, dt.27.03.1995, "Për krijimin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore" me qëllim krijimin e Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, inventarizimin dhe katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, krijimin e një database unike për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, materiale dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, katalogimin dhe ruajtjen e saj. Regjistrimi i objekteve kulturore konsiston në hedhjen e një mori informacionesh që bazohen në kartela tip që lëshon QKIPK.

QKIPK gjatë vitit 2016 në kuadër realizimit të objektivave lidhur me inventarizimin dhe katalogimin e pasurive kulturore ka kryer : inventarizimin dhe katalogimin e objekteve :

-Numri i objekteve të regjistruara në Fondin Kombëtar të Pasurive Kulturore, për vitin 2016 është **34,244**.

Ka përfunduar procedura për “Evidentimin dhe Listimin e Veprave të Artit Pamor si Buste, Përmendore, Lapidare, Memoriale, Shtatore etj.” në të gjithë teritorin vendit dhe është bërë regjistrimi i veprave të artit. **Totali në të gjithë teritorin i objekteve të rregjistruara në databazën kombëtare është 1323 objekte**, (Lapidarë, Buste, Shtatore, Monumente; Pllakate, Shatërvan, Bazoreliev, Obelisk, Përmendore; Memorial; Mozaik; Skulpturë, Statuja; Këmbanë; Reliev).

-Ka vijuar rregullisht procesi për zbulimin, inventarizimin, regjistrimin në databazën kombëtare të fondit të fotografisë, negativëve në xham, pjesë e fondit të Dhimitër Vangjelit pranë Muzeut Historik të Ersekës.

U zhvillua ekspozita “Kolonja përmes fotografisë së Dhimitër Vangjelit” në Bashkinë Ersekë në datën 29 Tetor 2016.

-Është në përfundim projekti “Botimi i katalogut të humbjeve në sistemin e trashëgimisë kulturore 1990/15” pjesë e databazës kombëtare.

➤ **F. Krijimi i Qendrave të informimit publik për rregjistrimin on-line të Pasurive Kulturore**

Në kuadër të Programit “Shqipëria dixhitale”- Ministria e Kulturës me Fondin për Zhvillimin e Rajoneve 2015-2016 po realizon projektin “**Krijimi i Qendrave të informimit public për rregjistrimin on-line të Pasurive Kulturore**” me vlerë totale 45.429.000 lekë.

Objektivi i Përgjithshëm i projektit është Krijimi i një Sistemi informatik kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore. Është dhe i një database unike për trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve, me qëllim identifikimin, katalogimin, ruajtjen dhe përdorimin e saj. Synimi është realizimi sipas të gjitha standarteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare ku të theksohet aksesimi i publikut dhe i institucioneve të interesuara për përdorim të lirë, por të shërbeje dhe si një strategji kombëtare në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurisë kulturore.

Sistemi do të mundësojë lidhjen në kohë reale online të këtij shërbimi: me institucionet në sistemin e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit, shërbimin doganor të RSh për monitorimin e lëvizjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore që dalin jashtë territorit të Shqipërisë, Policinë e Shtetit dhe pikat e kalimit kufitar, për shikëmbim informacioni në system lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore.

objektivat që mbart ky projekt :

1. Dizajnimi dhe zhvillimi i sistemit informatik të dixhitalizimit të Pasurive Kulturore Kombëtare Materiale dhe Jomateriale.
2. Hartimi i Databazës Kombëtare ëb.
3. Krijimi i Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin On-Line të Pasurive Kulturore Kombëtare.
4. Krijimi i infrastrukturës teknike dhe profesionale për shërbimin publik të QKIPK, në bazë të standardeve ndërkombëtare për informimin e qytetarëve mbi procedurat e regjistrimit dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri.
5. Zgjerimi dhe ndërlidhja e shërbimit publik të QKIPK me 6 qendrat e informimit të shërbimit publik pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe monitorimin e inventarit, dokumentacionin, ndryshimet dhe lëvizjet e trashëgimisë kulturore.
6. Infrastruktura e ngritur sipas standarteve të kerkuara dhe bashkëkohore.
7. Katalogu Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore i perditësuar dhe plotësuar.
8. Parandalimi i trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme përmes krijimit dhe përditësimit të bazave kombëtare të të dhënave të objekteve. Monitorimi i plote i lëvizjeve të objekteve për shkak të lidhjeve me doganat.
9. Identifikimi, regjistrimi dhe monitorimi i pasurive kulturore në R.SH.
10. Aksesimi i plotë i institucioneve që operojnë në fushën e trashëgimisë kulturore. Menaxhimi dhe kontrolli i pasurisë kulturore bazuar në të dhënat e identifikimit.

11. Akses i monitoruar i personave fizikë dhe personave juridikë privatë që posedojnë objekte trashëgimi kulturore.
12. Identifikimi i objekteve të humbura dhe lidhja me INTERPOL dhe sistemin TIMS.
13. Monitorimi periodik i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës.
14. Ndërlidhje dhe sigurimi i qasjes në informacion për grupet e interesit, (Ministria e Brendshme përmes kontrollit të saj të pikave doganore dhe identifikimin dhe mbrojtjen e kulturore, institucionet shkencore, muzetë, mbledhësit privat, si dhe publik për studimin e identifikimit, etj.), me kufizimet sipas karakteristikave të përdoruesit.

Projekti ka filluar zbatimin në vitin 2015 dhe aktualisht punohet paralelisht në disa faza të tij dhe pritet të përfundojë në vitin 2017.

1. Programi: “ART DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12– mujori 2016		Realizimi 12– mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08230	600-601	Paga, Sig.Shoq	507,974	49.1%	506,737	49.4%	99.8%
12	08230	602-606	Shpen.Korrente	258,745	25%	254,381	24.8%	98.3%
12	08230	231	Kapitale	267,573	25.9%	263,948	25.7%	98.6%
			TOTALI	1,034,292	100%	1,025,067	100%	99.1%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 99%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 49% të totalit dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet korrente zënë rreth 25% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 26% dhe janë realizuar në masën 99%. Mosrealizimi i fondeve në masën 0.9% konstatohet kryesisht në shpenzimet korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura				08230
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 12-mujori 2016	Buxhet/Fakt 12-mujori 2016
A-00325	Veprimtari te realizuara ne institucionet e art kultures	636,257	736,256	572,201	566,600
B-00325	Veprimtari te realizuara me fondet e programit art kultures	237,000	237,000	150,100	150,100
C-00325	Perfaqesimi ne programe dhe evenimente nderkombetare	44,418	44,418	44,418	44,418
D-00325	1 qender e re kulturore e krijuar	160,910	160,910	267,573	263,949
	Totali	1,078,585	1,178,584	1,034,292	1,025,067

Produktin (A): Veprimtari të realizuara në institucionet e Art Kulturës

Për realizimin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2016, Drejtoria e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës në zbatim të politikave dhe Programit Art-Kulturë 2013-2017, ka vijuar nga puna për arritjen e objektivave bazuar në Planifikimin e Buxhetit afat mesëm si dhe dokumentit që shoqëron atë Deklaratën e Politikës së Programit.

Sa më sipër, në bashkëpunim me të gjithë institucionet e vartësisë dhe iniciativave private në këtë fushë është konkluduar sipas parashikimeve realizimi i projekteve artistike kulturore, të cilat kanë siguruar gjithpërfshirje në jetën social kulturore, në vecanti ato projekte të cilat kanë në fokus krijimtarinë artistike, edukimin dhe zhvillimin e audiencave si dhe integrimin gjinor.

Projektet artistike me program aktivitetesh jashtë territorit të Shqipërisë kanë treguar rritje të nivelit artistik dhe nivelit të përfaqësimit përmes promovimit të produktit artistik shqiptar dhe nxitjes së konkurrencës mes protagonistëve në fushën e art kulturës.

Krijimtaria artistike në çdo disiplinë të artit ka vijuar të shfaqë interes për skenat ndërkombëtare dhe ndjehet një rritje interesi për bashkëpunime të përbashkëta kulturore, fakt që garanton qëndrueshmëri të produktit me periudha afat gjata.

Në lidhje me një nga objektivat e parashikuar për tu përmbushur si një detyrim me prioritet të lartë ligjor, ne kuader të realizimit të objektivave me baze gjinore të programit “Arti dhe Kultura”, tashmë është arritur me sukses përfshirja e buxhetimit gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm, 2015-2017. Bashkëpunimi mes stafit të MK, pikave të kontaktit dhe Ekspertëve të jashtëm ka qenë i frytshëm, duke e finalizuar kontributin në këtë objektiv.

(Informacion më i detajuar dhe i specifikuar sipas indikatorëve dhe treguesit përkatës për secilin nga Institucionet e artit dhe Kulturës, bashkëlidhur tabela statistikore për 12 e vitit 2016).

Produkti (B): Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë

(Zhvillim të Audiencave dhe Edukim Përmes Kulturës, përmes programeve dhe atelieve të edukimit në Institucionet e artit).

1. Nënshkrimi Memorandumit të Bashkëpunimit për Edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë, midis MAS dhe MK.
2. Rritja ndjeshëm e numrit të programeve artistike, projekteve kulturore për fëmijë, si dhe pjesëmarrja e shkollave për të marrë pjesë në aktivitetet artistike kulturore në Institucionet e Artit dhe Kulturës.
3. Kanë marrë rrugë projekte dhe programe specifike pilot dhe të qëndrueshme të artit në edukim.
4. Në institucionet e artit, janë finalizuar dhe shpallur publikisht kalendarët e posaçëm të edukimit përmes kulturës.
5. Janë ndërtuar strukturat e edukimit kulturor pranë institucioneve të varësisë.
6. Janë trainuar stafet përkatëse të këtyre strukturave.
7. Nënshkrimi i Protokollit dhe kalendare të përbashkët kulturor Shqipëri – Kosovë; mbi 20 projekte të bashkërenduara midis institucioneve dhe subjekteve të artit dhe kulturës, së dy vendeve.

Ndër të tjera projekte me thirrje nga 69 projekte ne total, janë realizuar 64 projekte nga subjekte po individ përfitues;

1. Shoqata Kulturore Artstike 'Iliria', për projektin Festivali 13-të Ndërkombëtar i Monodramës ' ALBAMONO'.
2. Shoqata Europiane e Teatrit Bashkëkohor Shqiptar A.T.K, për projektin Neë Energy/Energji.
3. Qendra Kombëtare e Teatrit Mesdhetar, për projektin Festivali 14-të Ndërkombëtar i Teatrit ' Butrinti 2000'.
4. Saimir Gongo, për projektin Aty ku dielli nuk perëndon.
5. Olta Daku, për projektin Shirli Valentine- monodrame.
6. Alma Hoti, për projektin Na te birtë e shekullit te ri.
7. Erion Kame, për projektin Një jetë me ty.
8. GlobArt, për projektin Marta.
9. Shoqata Kulturore "Eja në Teatrë", për projektin Verë në Epidamn.
10. Ermela Ruri, për projektin Tradhëtitë.
11. Artlink, për projektin Familja TOT.
12. Rozina Kostani, për projektin Kujtesa e ujit.
13. Shoqata artistike "Klaus'Film", për projektin Don Kishoti.
14. Fondacioni Qendra M.A.M, për projektin My name is Balkan.
15. Shoqata për Menaxhimin e Artit dhe Kulturës, për projektin Balkan Teater Tirana Fest.
16. Guitar Foundation of Albania, për projektin Festivali Ndërkombëtarë i Kitarës së Tiranës, Edicioni 4.
17. Shoqata "Bota e Artit", për projektin Maratona e muzikës violinistike, Edicioni VI-të.
18. Shoqata e Syrit Blu, për projektin International Festival "JAZZ in Albania & Ėorld Music" edicioni 5.
19. Rek Remont Kapital, Qendër Kulturore, për projektin KABA 2.0 Festival.
20. Organizata "Njerëz dhe Ide", për projektin Festivali MultiKulturor Berat-Edicioni III-2016.
21. Shoqata kulturore " Arti dhe kultura Italo Shqiptare, për projektin Festivali Ndërkombëtar i muzikës së dhomës-Durrës 2016.
22. Different Trains, për projektin Different Trains Festival.
23. A.C.S&Music Improvation, për projektin Flauti Magjik Edicioni 4.
24. Qendra Vox Baroque, për projektin Vox Baroque festivali i imuzikës së vjetër edicioni III-korrik 2016..
25. Shoqata "Kulture-Media-Art", për projektin Festivali Ndërkombëtar Operistik "Marie Kraja".
26. Shoqata "Shpirti artistik I Shkodres ", për projektin Festivali I 54 mbarëkombëtar I këngës për fëmijë.
27. Albanian composers association, për projektin Balkan Contemporary music festival.
28. Shoqata " Durres Beauty ", për projektin Albania Dance meeting-festival.
29. Boom Boom events, për projektin Koncert " Trillet e Mozartit".
30. Fondacioni I Olimpiti, për projektin Rock Symphony concert.
31. Shoqata Kulturore "Skampa", për projektin Takim kombëtar i orkestrave të harqeve:muzika e dhomës dhe krijimtaria e saj.
32. Shoqata "Artistët interpretë", për projektin International Festival Brass.
33. Elsamed Senaj, për projektin Shkodra Fest.
34. Armela Demaj, për projektin Këngët e Pafajësisë Ėilliam Blake.
35. Adriana Dizdari, për projektin Këngët e Tokës.
36. Gezim Belegu, për projektin Tinguj dhe Monumente.
37. EA.Zaharian/Endri Sina, për projektin Romanca Shqiptare.

38. Milen Nikolla, për projektin Koncert për piano dhe Orkestër Cesar Frank.
39. Genti Tavanxhiu, për projektin Skulptura e parkut 2016.
40. Grupi 'Plener Art', për projektin Ekspozitë në Muzeun Historik Kombëtar.
41. Instituti I Artit Bashkekohor Tiranë,TICA, për projektin Programi I Residencave AIR-LAB.
42. Shoqata ANTIK, për projektin Art Colony POGRADECI '16.
43. Shoqata Kulturore Vizart, për projektin Festivali i 2-të ndërkombëtar i akvarelit.
44. Giada Kuka, për projektin Arti, fëmijët dhe muzeu, në shumën 209.000 lekë.
45. Universiteti POLIS, për projektin Javët e Arkitekturës në Tiranë 2016: Në mes të "Amerikave dhe Azisë"- Arkitektura pas globalizmit.
46. Instituti i Studimeve Politike, për projektin Lugina e qendrës.
47. Consulting and development partners, për projektin Arthouse 2.
48. MIZA, për projektin Programi artistik I hapësirës MIZA.
49. Qendra Zeta, për projektin 9 vjet Zeta.
50. Cross Culture, për projektin Rrugëtim i Galerisë Kombëtare të Arteve, Muzeut Kombëtar dhe Kalasë së Krujës në realitetin virtual.
51. Tirana Art Lab, për projektin The first solo shoë.
52. ASA Ekspozite Rome, për projektin Art Folk vol.5.
53. DSA, për projektin Te jetosh me 47 kromozome.
54. Qendra SHq per Sherbime Pskologjike dhe Terapeutike, për projektin Fotografia e 21-te.
55. Metroresearch, për projektin Ciceroni virtual.
56. Shtëpia filmike "d'ART", për projektin First Step Film Fest #3 - Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Studentë.
57. Ora Film Marubi, për projektin Festivali ndërk.për të drejtat e njeriut në Shqipëri edic.XI.
58. Anifest, për projektin Festivali ndërkombëtar i filmit për fëmijë, për adoleshentë.
59. Tirana Film Institute, për projektin Docutiff, Festivali Nderkombëtarë i Filmit Dokumentar 2016.
60. Art-Im-Pulse, për projektin Festivali I Filmit Ballkanik dhe Artit Kulinar.
61. Multimedia studio "Nositi";1-vera e kinemasë europiane Gjirkoastër, Sarandë, Pogradec; kinema ne shkolle, për projektin Dea open air International Film Festival/edicioni I 3 Sarande-Gjirokastr.
62. Shoqata për zhvillimin e turizimit kulturor, për projektin Tirana 48 hour Film Project.
63. Open Mind, për projektin Arkivat ne levizje : Shkolla verore për ruajtjen dhe restaurimin audiovizual.
64. Auleda, Agjencia e zhvillimit ekonomik lokal, për projektin Biennale I-r të fotografisë artistike EXPO "The fugitives" të artistit Andreas Zeppelzauer.

Projekte të mbështetura nga programi art-kulturë (zëri 604), jashtë thirrjes me aplikim për vitin 2016 të ndjekura nga DKPEK:

1. Realizimi festivalit të 52 të këngës për fëmijë që u zhvillua nga QKKFTK, në datat 30 – 31 maj dhe 1 qershor 2016 në TKOB.
2. Realizim i katalogëve me veprat e piktorëve Pandi Mele dhe Lumturi Dhrami
3. Realizimi i ekspozitës vetjake të artistit Agron Jano, në GKA më 5 maj 2016
4. Mbështetja e projektit Eorl Id Day- "Organizimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale – 26 Prill 2016 dhe "Konferencë Kombëtare"
5. Mbështetja e projektit "Top Aëards" i cili u realizua nga Fondacioni "Dritan Hoxha" në datën 24 qershor 2016 në Pallatin e Kongreseve.
6. "Shtëpisë së Artistit" Tiranë, nga datat 15 shtator – 30 tetor në Tiranë për vitin 2016.

7. Alban Hajdinaj në aktivitetin përmbyllës të ekspozitës “*Balena që ishte nënndetëse. Pozicione nga Shqipëria dhe Kosova*”, Budapest, Hungari në datat 09 - 12 shtator 2016.
8. Programi Rezidencial Ndërkombëtar “Cittadellarte”, Itali. Ky projekt u lançua më 08.07.2016. Pas konkursit të shpallur më 15 korrik 2016, artistët e përzgjedhur nga personalitetet artistike të UNIDEE, “Cittadellarte” 2016 që përfitojnë dy bursat nga Ministria e Kulturës Shqiptare janë; **Bib Frrokaj dhe Lek Gjeloşi**.
9. Përfaqësimin e Shqipërisë dhe pjesëmarrjen e regjisorit Florenc Papas, në Midpoint Karlovy Vary që do të zhvillohet në Çeki, në datat 5 - 8 korrik 2016”.
10. Përfaqësimi i Shqipërisë dhe pjesëmarrja e grupit Iso-polifonik “Jonian”, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër Dokufest 2016, që u zhvillua në Prizren-Kosovë, në datat 5 - 13 gusht 2016”.
11. Përfaqësimin e Shqipërisë dhe pjesëmarrjen e skenaristes Iris Elezi me projektin Kinemateka Shqiptare, në programin SOFA në Poloni në dt. 18/29 Gusht, 2016.
12. Mbështetja e Festivalit Mbarëkombëtar i Komedisë “Aleko Prodani”, që u mbajt në Korçë, nga datat 4 deri më 10 shtator 2016.
13. Mbështetja e projektit “*AIM ëorkshops/Punëtori Arkivat në lëvizje*”, mbi ruajtjen, restaurimin audiovizual, të filmit shqiptar pjesë e fondeve arkivore shtetërore shqiptare, që u zhvillua përgjatë datave 17-28 Tetor 2016 në Tiranë pranë AQSHF, në mbështetje të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore si dhe promovimin e krijimtarisë filmike kombëtare.
14. “Shtëpisë së Artistit” Tiranë, nga datat 15 shtator – 30 tetor në Tiranë për vitin 2016.
15. Programi “UNIDEE 2016”, Biella Itali Bib Frrokaj dhe Lek Gjeloşi në Programin Rezidencial Ndërkombëtar “Cittadellarte”, Itali në datat 10 – 21 tetor 2016
16. “Shtëpia e Artistit”, Felix Baltzer, Tiranë 15 Shtator – 30 Tetor 2016.
17. “P’rrall” album i Koncertit muzikor 25 nëntor, Tiranë i kompozitorit Bashkim Rodoni.

Produkti (C), Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare

(Rritja e bashkëpunimeve dhe përfaqësimeve të artit dhe artistëve shqiptar në evenimente dhe skena ndërkombëtare)

Projekte jashtë thirrjes me aplikim për vitin 2016 të ndjekura nga DKPEK, me destinacion produkti C:

1. Përfaqësimi i Kulturës Shqiptare me Festivalin “Balkan Trafik”, Belgjike Vikena Kamenica, Keli Bank dhe Grupi Ali Pashë Tepelena.
2. Përfaqësimi i Arkivit Qëndror Shqiptar i Filmit në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar “Cinema du Reel, në Paris Francë.
3. Përfaqësimi i Filmit dhe Kineastëve Shqiptar në Festivalin Nderkombetar i Filmit, Berlinale, Gjermani.
4. Pjesëmarrja e Ansambli Popullor në koncertin e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Kuvajtit për Kulturën Artin dhe Letrat, Kuvajt.
5. Konkurimi i Filmit “Bota” me regji dhe skenar nga Iris Elezi dhe Tomas Logoreci, në garën e filmit të Huaj_Oscar, USA.
6. Zhvillimi i Ansamblesë EUROIMAGE, në Tiranë.

7. Perfaqesimi Artistit Shqiptar Eros Dibra, fitues i Onufri, në Residencën e Dysseldorf.
 8. Përfaqësimi i artistit Driant Zeneli, në shtëpinë e Artistit në Salzburg.
 9. Përfaqësimi i Shqipërisë me pjesëmarrjen e Qendrës Kulturore për Fëmijë në Festivalin Ndërkombëtar të 38, të fëmijëve Antalia Turqi;
 10. Përfaqësimi dhe pjesëmarrjen e trupës së balëtit të TKOBAP, në Festivalit e 13-të të Dansit në Novi Sad, Beograd dhe Nis, të Serbisë.
 11. Ekspozitë e artit në poster e artistit hungarez Pëterpocs, me vepra të fondit të GKA-së, ekspozuar në Galerinë e Kombëtare të Arteve Prishtinë.
 12. Përfaqësimi i Shqipërisë dhe pjesëmarrjen e ansamblit popullor në festivalin e kulturës shqiptare në mantova, itali që do të mbahet përgjatë datave 10-11-12 qershor 2016
 13. Realizimin e bashkëproduksionit teatral, shfaqja artistike “Romeo e Zhuliet”, mes tre vendeve Shqipëri-Serbi-Kosovë, pranë Teatrit Kombëtar në Tiranë”, gjatë muajit qershor 2016
 14. Realizimi Turit Koncertor i zhvilluar nga Vlashent Sata dhe grupi i tij në 24 maj në Teatrin Migjeni, Shkodër, në 25, 26 maj në Teatrin Metropol, Tiranë, dhe 3 qershor në Paris, Francë për vitin 2016.
 15. Përfaqësimin e Shqipërisë në edicionin e 10 jubilar të Festivalit Ndërkombëtar Kulturor “Ballkan Trafik”, që do të zhvillohet në Bruksel, në datat 14-17 prill 2016”
 16. Financimin e Përfaqësimit të Shqipërisë nëpërmjet Grupit Muzikor Fanfara në koncertin e 1 majit, Romë, Itali
 17. Përfaqësimin e Shqipërisë në aktivitetet që do të zhvillohen në Kinë, në kuadër të nismës Kinë-Vendet e Evropës qendrore dhe lindore, për vitin 2016
 18. Thirrje për projekte: Pavijoni Shqiptar në Bienalen e Venecias, 2017
- Ekspozita 57-Të Ndërkombëtare e Artit - Bienale e Venecias 2017**
19. Bienalen e Artistëve të Rinj nga Europa dhe Mesdheu, që do të zhvillohet në Tiranë dhe Durrës më 4-9 Maj 2017.

Produkti D, (Investimet në qendrat kulturore)

1. Më 29 dhjetor 2016 u Inagurua, Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Tiranë. Më këtë investim u hapën mundësira të reja argëtimi dhe formimi artistik fëmijëve në Tiranë. Kjo iniciativë do të zgjerohet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.
2. Ndër të tjera vijon procesi i punës në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikostruksione infrastukture në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës;
 - TKOB (ne proces pune)
 - Teatri Migjeni, Shkodër (drejt perfundimit)
 - Teatri Andon Zako Cajupi, Korçë (perfunduar)

Informacion mbi kontratën me objekt: “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikës, në Qendër Arti Skena e Re - Faza II Punime Ndërtimore”

Leja e ndërtimit:

Kombëtar i Territorit

Data e fillimit të punimeve: 18.08.2016.

Data e përfundimit të punimeve: 18 muaj pas fillimit te punimeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kane filluar punimet në objektin: “Rikonstruksion dhe ndryshim Destinacioni i Ish Laboratorit të Hidroteknikës, në Qendër Arti Skena e Re - Faza II Punime Ndërtimore”, në bazë të kontrates Nr. 214, datë 28.06.2016, të lidhur midis Investitorit - Ministria e Kulturës dhe Sipërmarrësit - Shoqëria “EDIL AL” sh.p.k.

Vendimi Nr. 166, datë 27.08.2015 nga Këshilli

